

INFORMACION MBI ZHVILLIMIN E TAKIMIT DIALOG PËR SIGURINË PUBLIKE: KËSHILLI VENDOR, TË RINJTË DHE PREZENCA E OSBE NË SHQIPËRI

Vendi: “Ndihma e Ëeilheim për Shqipërinë”

Data: 3 Prill 2026

Ora: 10:30-12:30

Tema e takimit: Të rinjtë për sigurinë publike

Të pranishëm në takim: 25 pjesëmarrës

Moderator: Ervin Muço, Koordinator i KVSP Elbasan.

Në datën 3 Prill 2026, në ambientet e “Ndihma e Ëeilheim për Shqipërinë” në Elbasan, me praninë e Ambasadorit të OSBE në Shqipëri, z. Michel Tarran, u zhvillua takimi me fokus përfshirjen e të rinjve në sigurinë publike, bashkëpunimi me KVSP, si edhe roli i prezencës së OSBE në adresimin e çështjeve të lidhura me sigurinë. Aktiviteti kishte në fokus rritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjen aktive të të rinjve në çështjet e sigurisë publike si edhe prezantimin e fushatës së OSBE: “S’ka shkurt”.

Aktiviteti nisi me vizitën në ekspozitën e punimeve të të rinjve, si dhe me shfaqjen e videove ndërgjegjësuese mbi parandalimin e përfshirjes së të rinjve në krimin e organizuar. Kjo pjesë shërbeu për të reflektuar mbi sfidat dhe rreziqet që has rinia.

U prezantua aplikacioni “**Raporto Tani**”, një mjet që synon të lehtësojë raportimin e rasteve që lidhen me sigurinë publike. U theksua rëndësia e përdorimit të teknologjisë për rritjen e bashkëpunimit mes qytetarëve dhe institucioneve.

U zhvillua një dialog i hapur midis të rinjve, përfaqësuesve institucionalë dhe ambasadorit të OSBE z. Michel Tarran. Diskutimet u fokusuan në:

- rolin e të rinjve në garantimin e sigurisë publike;
- sfidat që lidhen me narrativat mashtruese të “suksesit të shpejtë” që përdoren nga rrjetet kriminale;
- nevojën për promovimin e modeleve pozitive dhe forcimin e komunikimit ndërmjet të rinjve, institucioneve dhe komunitetit.

Hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (Open Government Partnership - OGP) 2026 -2030, për komponentin “*Funksionimi i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publik*”

Gjatë takimit u prezantuan hapat teknikë për hartimin e planit për Qeverisjen e Hapur (PQH/OGP), duke u ndalur në metodologjinë e ndjekur, objektivat kryesore dhe afatet e parashikuara për zbatimin e tij.

Pjesëmarrësit trajtuan rëndësinë e forcimit të rolit të institucioneve vendore, policisë, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë relevantë në kuadër të funksionimit të këtyre

këshillave, duke evidentuar nevojën për komunikim të vazhdueshëm dhe shkëmbim të rregullt informacioni. Në vijim të diskutimeve, përfaqësuesit e institucioneve dhe aktorëve të interesuar ndanë mendime, komente dhe propozime konkrete mbi mënyrat e përmirësimit të koordinimit ndërinstytucional dhe rritjes së përfshirjes së komunitetit në proceset vendimmarrëse.

Gjithashtu, gjatë takimit, u theksua se funksionalizimi efektiv i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike mbetet një element kyç për ndërtimin e politikave të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në fushën e sigurisë publike.